



BISHZ - VAIS - UIAS

BASHKIMI I INTELKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR
VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELLEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ
UNION DES INTELLECTUELS ALBANAIS EN SUISSE
UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA

Mühledorfstrasse 13 - 3018 Bern • Email: sekretariati@bishz.ch • www.bishz.ch

RAPORTI VJETOR NR. 9

BISHZ - VAIS - UIAS

19.11.2005 - 18.11.2006

Dr. Sc. Ahmet XHIGOLI



RAPORTI VJETOR NR. 9

BISHZ - VAIS - UIAS

19.11.2005 - 18.11.2006

Dr. Sc. Ahmet XHIGOLI

Titulli:	RAPORTI VJETOR NR. 9
Faqe:	16
Viti:	2006
Vendi:	Bernë, Zvicër
Botuesi:	BISHZ, Mühledorfstrasse 13, 3018 Bern
Gjuha:	Shqip
Tirazhi:	100 kopje
U shpërndahet:	Anëtarëve të Kuvendit të nëntë të rregullt të BISHZ-së dhe mysafirëve të ftuar.

Publikimin e këtij raporti e ka lejuar kryetari i Bashkimit të Intelektualëve Shqiptarë në Zvicër në Bernë më 16.11.2006, kurse shtypjen e tij e ka bërë arkëtari Ismet Rexhaj.

Copyright © BISHZ – VAIS – UIAS, Bern. Alle Rechte vorbehalten.

Lidhur me këtë raport

Ky raport paraqet aktivitetin e BISHZ-së në periudhën prej 19.11.2005 deri më 18.11.2006 dhe vlenë për Kuvendin e BISHZ-së. Dokumentet përcjellëse të tij janë: Statuti, Programi i punës, Rregullorja e Kryesisë, Paraqitja e Shoqatës, Vendimet e marrura nga mbledhjet e Kryesisë, Sekretariatit, Seksioneve, Grupeve punuese dhe Komisioneve të caktuara të BISHZ-së; Qëllimet e Shoqatës për vitin 2006; Protokolet e Kryesisë, Sekretariatit dhe Seksioneve. Raporti mund të zgjerohet me kërkesën e Kuvendit të BISHZ-së.

Raporti është i strukturuar në 8 kapituj. Në kapitullim e parë është dhënë një përshkrim i shkurtër i Kuvendit të tetë të rregullt. Në kapitullin e dytë është përshkruar organizimi i Orës Letrare "Kërkojmë recituesin më të mire", kurse në kapitullin e tretë është dhënë definimi i aktiviteteve për vitin 2006. Në kapitujt 4 dhe 5 në formë tabelare është dhënë lista e detalizuar e aktivitetit të Kryesisë dhe Sekretariatit.

Në kapitullin e gjashtë është dhënë veprimtaria e seksioneve për këtë vit. Shkurtimisht është përshkruar organizimi i turnirit në futboll të vogël, organizimi i takimit familjar, dhe organizimi i tryezës së rrumbullakët tradicionale me rastin e 7-vjetorit të çlirimit të Kosovës.

Kapitulli i shtatë jep të dhënat e aktivitetit të veprimtarisë botuese të BISHZ-së, kurse kapitulli i tetë jep listën aktuale të udhëheqësisë së BISHZ-së.

Dr. Sc. Ahmet Xhigoli

Kryetar i BISHZ-së

Përmbajtja

Faqe

1.	Kuvendi i tetë i rregullt	5
2.	Organizimi i Orës Letrare “Kërkojmë recituesin më të mire”	6
3.	Definimi i aktiviteteve për periudhën 01.01.2006 - 31.12.2006	7
4.	Kryesia	7
5.	Sekretariati	10
6.	Seksionet e BISHZ-së	11
6.1.	Organizimi i Turnirit në futboll të vogël	11
6.2.	Organizimi i Takimit familjar.....	14
6.3.	Organizimi i Tryezës së Rrumbullakët me rastin e 7-vjetorit të çlirimit të Kosovës	15
7.	Veprimtaria botuese	15
8.	Lista aktuale e udhëheqësisë së BISHZ-së	16

1. Kuvendi i tetë i rregullt

Më datën 18.11.2005, në lokalet e Qendrës shkollore për arsimim profesional "Formazione" në Bernë, është mbajtur Kuvendi i tetë i rregullt i BISHZ-së dhe promovimi i librit "Makinat Elektrike Komplemetare-Komplekse" i autorit Dr. Sc. Rifat Gjota. Në Kuvend merrnin pjesë rreth 50 veta. Punimet e kuvendit dhe promovimin e përcollën edhe dy gazetarët e shquar, zotërinjt Rexhep Rifati dhe Xhevdet Kallaba nga Bota Sot.

Në pjesën e parë të këtij takimi, nga ana e kryetarit është dhënë një vështrim i shkurtër i punës tetëvjeçare të BISHZ-së, është paraqitur raporti i punës për periudhën 19.11.2004 - 18.11.2005, është bërë zgjedhja e Kryesisë së re dhe Komisionit të kontroll-revizionit për periudhën 2005-2007, dhe janë ndarë 8 mirënjohje.

Në pjesën e dytë është bërë promovimi i librit të përmendur, ku vetë autori në kohën prej gjysëm ore bëri paraqitjen e rezultateve të punës së tij kërkimor shkencorë disavjeçare në fushën e Makinat Elektrike Komplemetare-Komplekse. Paraqitja e rezultateve të punës shumëvjeçare të shkencëtarit dhe pedagogut të shquar nga Kosova u pritën mjaft mirë nga të pranishmit.

Pas përfundimit të këtij aktiviteti, kryesia shtroi një darkë të përbashkët me anëtarët e BISHZ-së, familjarët e tyre dhe mysafirët e ftuar.



Një seqencë gjatë paraqitjes së rezultateve të punimit me rastin e promovimit të librit.

Shkencëtari dhe pedagogu i mirënjohur dr. Rifat Gjota ka lindur në Pejë më 5 Maj 1939 në një familje të njohur zejtare. Shkollën fillore dhe Gjmnazin e kreu në vendlindjen e vet. Në vitin 1965 ka diplomuar në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Shkupit, në vitin 1977 ka magjistruar në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit, kurse në vitin 1985 ka doktoruar në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës.

Libri i dr. Rifat Gjota, "Makinat Elektrike Komplementare-Komplekse" është botuar nga shtëpia e njohur botuese "Dukagjini" në Pejë. Libri është një referencë e përshtatshme për inxhinierë dhe të interesuarit e tjerë që ballafaqohen me probleme në këtë fushë moderne si në aspektin teorik edhe në atë praktik. Libri ka për rezensent profesorët e Univeristetit të Prishtinës, prof. dr. Mehmed Bula dhe prof. dr. Halil Turku.

Prof. dr. Rifat Gjota është ndër të mirënjohës ndaj Bashkimit të Intelektualëve Shqiptarë të Zvicrës, të cilët me kontributin e tyre bënë të mundur promovimin e këtij libri në Zvicër.

Në këtë Kuvend, BISHZ-ja e ka shpall Anëtar Nderi dr. Rifat Gjetën.

2. Organizimi i Orës Letrare “Kërkojmë recituesin më të mire”

Më datën 26.11.2005, në lokalet e Shkollës Fillore “Hermesbrühl” në Solothurn, Seksioni për arsim i BISHZ-së në bashkëpunim me Këshillin e Lidhjes së Arsimtarëve dhe Prindërve Shqiptarë të Kantonit të Solothurnit, për nder të Festës së Flamurit, ka organizuar një manifestim kulturor në temën, Orë Letrare “Kërkojmë recituesin më të mire”. Në këtë manifestim morën pjesë mësimdhënës me grupe nxënësish nga disa Kantone të Zvicrës, prindërit dhe familjarët e nxënësëve si dhe mysafirë të ftuar.

Në këtë orë letrare janë recituar dhe interpretuar rreth 20 poezi dhe vjersha, një recital dhe një skeq i përbashkët. Në bazë renditjes, Flamur Saqipi nxënës i klasës së pestë ka recituar poezinë “Dita e Flamurit”, Adrian Xhigoli nxënës i klasës së tetë ka recituar poezinë “Shqyponia”, Arta Balaj nxënës e klasës së katërt ka recituar vjershën “Vendi im”, Lindiana Zyberi dhe Arjeta Ramani nxënës të klasës së dytë kanë recituar së bashku vjershën “Sa të dua o Shqipëri”, Nora Sejdiu nxënës e klasës së tretë ka recituar vjershat “Hasan Prishtina në megrim” dhe “Lulëkuqja”, Krenar Musa nxënës i klasës së tretë ka recituar vjershën “Gjuha”, Abetare Balaj nxënës e klasës së gjashtë ka recituar poezinë “A është fajtor shqipëtar”, Lumturije Sadiku nxënës e klasës së tetë ka recituar poezinë “Durimi”, Besmir Ramani nxënës i klasës së pestë ka recituar vjershën “I dashuri Atdhe”, Igball Zyberi nxënës e klasës së gjashtë ka recituar vjershat “Jeta” dhe “Pula”, Shqiprina Saqipi nxënës e klasës së nëntë ka recituar poezinë “Ukshin Hoti”, Jehona Musa nxënës e klasës së pestë ka recituar vjershën “Mëmëdheu”, Dardan Avdyli nxënës i klasës së katërt ka recituar vjershën “Kujtoj mësuesin”, Nora Balaj nxënës e klasës së dytë ka recituar vjershën “Shqiponja”, kurse Donika Sejdiu nxënës e klasës së pestë ka recituar vjershën “Hymni i Flamurit”. Recitalin e përbashkët “Jeta” e kanë interpretuar të gjithë nxënësit pjesëmarrës, kurse skeqin “Egoizmi dhe Solidariteti” e kanë interpretuar një grup nxënësish nga Kantonit i Solothurnit. Qëllimi i kësaj ore letrare ishte edhe nxitja e fëmijëve për një përsosshmëri të teknikës së të recituarit, prandaj edhe i dham kuptim garues.



Në anën e majtë është sekretari i BISHZ-së duke lexuar referatin për 28 nëntorin, pastaj vjen nxënësja Abetare Balaj e cila ekzekutoi Hymnin e Flamurit me rastin e hapjes së manifestimit, në mes janë nxënësit duke vallëzuar, kurse në anën e djathtë është juria prej tre anëtarëve, Resmije Berisha, Dr. Xhevat Salihu dhe Vaxhid Saqipi.



Në anën e majtë është një pamje nga Recitali “Jeta” e autorës Gonxhe Bojaxhiu-Nënë Tereza interpretuar nga nxënësit e Solothurnit, kurse në anën e djathtë një pjesë nga skeqi “Egoizmi dhe Solidariteti”, luajtur po ashtu nga nxënësit e Solothurnit

Në bazë të vlerësimit të jurisë u bë shpallja e më të mirëve. Vendi i parë i takoi Shqiprina Saqipi me poezinë kushtuar Ukshin Hotit, vendi i dytë u takoi: Donika Sejdiu me poezinë Hymni i Flamurit, Lumturije Sadiku me poezinë “Durimi” dhe Flamur Saqipi me poezinë “Dita e Flamurit”, vendi i tretë u takoi: Abetare Balaj me poezinë “A është fajtor Shqipëtar”, grupit të nxënësve me recitalin “Jeta”, Florian Xhigoli për rolin te skeqi “Egoizmi dhe

solidariteti". Me këtë rast, kryetari i BISHZ-së u ndau shpërblime dhe dhurata modeste për të gjithë nxënësit e pranishëm.



Në anën e majtë është një sequencë e ndarjes së shpërblimeve dhe dhuratave modeste për nxënësit e pranishëm, në mes nxënësit të cilëve më herët u janë ndarë dhuratat dhe shpërbimet e merituar, kurse në anën e djathtë një foto e përbashkët me prindërit pjesëmarrës.

Në fund të këtij përshkrimi të shkurtër, për kontributin në përkrahjen dhe realizimin e këtij manifestimi kulturor, Kryesia e BISHZ-së posaçërisht i falënderon: udhëheqësen e Seksionit për arsim si dhe këshillëtarin e BISHZ-së, Resmije Berisha, sekretarin e BISHZ-së dhe njëherit kryetar i Këshillit Kantonal të LAPSH të Solothurnit, Abas Fejzullahi; këshillëtarin e BISHZ-së, Dr. Xhevat Salihu dhe mësimdhënsin Vaxhid Saqipi.

3. Definimi i aktiviteteve për periudhën 01.01.2006- 31.12.2006

Në mbledhjen e kryesisë të datës 22.04.06 është aprovuar programi i aktiviteteve të ardhshme të BISHZ-së për këtë vit, si dhe plani i organizimit të mbledhjeve të kryesisë dhe sekretariatit. Në këtë drejtim janë definuar këto aktivitete themelore: aktualizimi i Web-faqës së BISHZ-së me të dhënat e reja dhe korigjimi i gabimeve ekzistuese; organizimi i një turniri në futboll të vogël; organizimi i një takimi familjar me anëtarët e BISHZ-së dhe familjarët e tyre; organizimi i një tryeze të rrumbullakët me rastin e shtatë-vjetorit të çlirimit të Kosovës; promovimi i katër librave të autorëve shqiptarë që jetojnë në Zvicër dhe Kosovë; organizimi i Kuvendit të nëntë të rregullt; shënimi i ditës së Flamurit; si dhe është theksuar që BISHZ-ja me vëmendje të përcjell zhvillimet në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, në trevat tjera shqiptare, Zvicër dhe që qëndrimet e saja lidhur me çfarëdo zhvillimi t'ia paraqesë opinionit shqiptarë, zvicëran dhe më gjërë.

4. Kryesisa

Në këtë kapitull është dhënë lista e detalizuar e aktivitetit të Kryesisë në periudhën 19.11.2005 – 18.11.2006.

AKTIVITETI I GJERËTANISHËM I KRYESISË					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
01	19.11.05	Kuvendi i tetë i rregullt i BISHZ-së	Vendi i mbajtjes: FORMAZIONE (ish CISAP-), Freiburgstrasse 139c, 3008 Bern. Data: E shtunë, 19 nëntor 2005, 17.00 - 19.30 Kryesues: Ahmet Xhigoli Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar) Pjesëmarrës: 56 <u>Pikat e rendit të mbledhjes</u> Pjesa e parë - Kuvendi i tetë • Hapja e Kuvendit • Fjala hyrëse dhe vështrim i shkurtë i punës tetëvjeçare të BISHZ-së.	Ftesë, Protokoli i Kuvendit të gjashtë të rregullt Dokument	AXH SSH AXH

			<ul style="list-style-type: none"> • Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 19.11.2004 - 18.11.2005. • Diskutim i hapur • Zgjedhja e Kryesisë së re dhe Komisionit të kontroll-revizionit. <ul style="list-style-type: none"> - Zgjedhja e Kryesisë së re sipas nenit 5c të Statutit. - Zgjedhja e Komisionit të kontroll-revizionit sipas nenit 5d të Statutit • Ndarja e mirënjohjeve. • Të ndryshme. • Mbyllja e Kuvendit. <p>Pjesa e dytë: Promovimi i librit “Makinat Elektrike Complementare-Komplekse” i autorit Dr. Sc. Rifat Gjota</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fjala Hyrëse • Paraqitje e shkurtër e jetëshkrimit të Dr. Sc. Rifat Gjota • Paraqitja e disa rezultateve të përshkruara në libër • Diskutim i hapur • Mbyllja e promovimit <p>Pjesa e tretë: Darka e përbashkët me anëtarët e BISHZ-së, familjarët e tyre dhe mysafirët e ftuar.</p>	<p>Raporti nr. 8</p> <p>8 Mirënjohje</p> <p>Dokument</p>	<p>AXH</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>AXH</p> <p>Të gjithë</p> <p>AXH</p> <p>SSH</p> <p>AXH</p> <p>Rifat Gjota</p> <p>Të gjithë</p> <p>AF</p>
02	26.11.05	Manifestim kulturor për nder të festës së Flamurit Kombëtar “Orë letrare me titull: Kërkojmë recituesin më të mirë”	<p>Vendi i mbajtjes së Manifestimit: Shkolla Fillore “Hermesbühl” në Solothurn</p> <p>Data: E shtunë, 26 nëntor 2005 / 14.00-17.00</p> <p>Kryesuese: Remije Berisha dhe Abas Fejzullahi</p> <p>Protokoli: Resmije Berisha (këshilltare)</p> <p>Pjesëmarrës: 60</p>	Ftesë, Protokoli i manifestimit kulturor	RB, AF
03	16.01.06	Letër-Ngushëllime	<p>Letër e Bashkimit të intelektualëve shqiptarë në Zvicër, ku përmes mjeteve të informimit u ka shprehur ngushëllime të sinqerta dhe e ka ndarë dhimbjen e madhe me familjën e nderuar të të ndjerit imzot Mark Sopit, Ipeshkvin e Kosovës, Kancelarin Ipeshkvor Dr. Don Shan Zefin, dhe me të gjithë miqt të z. Mark Sopit kudo në trojet e Shqipërisë etnike dhe në mërgatë.</p>	Letër-Ngushëllime	AXH
04	22.01.06	Letër-Ngushëllime	<p>Letër e Bashkimit të intelektualëve shqiptarë në Zvicër, ku përmes mjeteve të informimit u ka shprehur ngushëllime të sinqerta dhe e ka ndarë dhimbjen për vdekjen e parakohshme të dr. Ibrahim Rugovës, me familjën e tij, me të gjitha Intitucionet e Kosovës, me të gjithë miqt dhe bashkëpunëtorët e tij, dhe me gjithë popullin e Kosovës dhe popullin shqiptarë në përgjithësi.</p>	Letër-Ngushëllime	AXH
05	22.04.06	Mbledhja e parë e Kryesisë së BISHZ-së	<p>Vendi i mbajtjes: Qendra e nënave –Mutter Zentrum Wildmannstrasse 15, 3027 Bern-Bethlehm</p> <p>E shtunë, 22 prill 2006 / 17.30-20.30</p> <p>Kryesues: Ahmet Xhigoli</p> <p>Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar)</p> <p>Pjesëmarrës: 10 anëtarë</p> <p><u>Pikat e rendit të mbledhjes</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Vërejtjet dhe plotësimet e raportit vjetor nr. 8, dhe aprovimi i tij. • Vërejtjet dhe plotësimet e protokolit të mbledhjes së Kuvendit të tetë të rregullt, dhe aprovimi i tij. 	<p>Ftesë,</p> <p>Raporti vjetor nr. 8,</p> <p>Protokoli i mbledhjes së Kuvendit të tetë</p>	<p>AXH</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p>

			<ul style="list-style-type: none"> • Aktualizimi i Web-faqës së BISHZ-së me të dhënat e reja. • Organizimi dhe anëtarësia. • Aktivitetet e BISHZ-së për vitin 2006. <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i turnirit në futboll të vogël (data dhe vendi mbajtjes). - Organizimi i takimit familjar (data dhe vendi i mbajtjes). - Organizimi i tryezës së rumbullakët (data dhe vendi i mbajtjes). - Promovimet për këtë vit. - Organizimi i javës së Kulturës Shqiptare në Zvicër (data dhe vendi i mbajtjes). - Festimi i ditës së Flamurit. - Aktivitetet tjera? • Orari i mbledhjeve të Kryesisë/Sekretariatit për këtë vit dhe Kuvendit të nëntë të rregullt. • Të ndryshme. 		<p>AM, AXH</p> <p>Të gjithë</p> <p>AG, AF, SSH</p> <p>AXH, IR, SSH, AF</p> <p>AXH, IR</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p>
06	27.10.06	Mbledhja e dytë e Kryesisë së BISHZ-së	<p>Vendi i mbajtjes: Qendra e nënave –Mutter Zentrum Wildmannstrasse 15, 3027 Bern-Bethlehem</p> <p>E shtunë, 27 tetor 2006 / 17.30-20.30</p> <p>Kryesues: Ahmet Xhigoli</p> <p>Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar)</p> <p>Pjesëmarrës: 9 anëtarë</p> <p><u>Pikat e rendit të mbledhjes</u></p> <p>Pjesa e parë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vërejtjet dhe plotësimet e protokolit të mbledhjes së Kryesisë të datës 22.04.2006, dhe aprovimi i tij. • Organizimi i Kuvendit të nëntë të rregullt dhe propozimet <ul style="list-style-type: none"> - Vendi i mbajtjes së Kuvendit të nëntë të rregullt - Aprovimi i përmbajtjes së ftesës dhe listës së pjesëmarrësve - Gjendja e përpilimit të raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 19.11.05-18.11.06. - Raporti i mbledhjes së komisionit të kontroll-revizionit për periudhën 19.11.05-18.11.06. - Detyrat tjera operative për mbledhjen e Kuvendit. <ul style="list-style-type: none"> - Shtypja e raportit në rreth 100 kopje dhe lidhja e tyre. - Sjellja e një foto-aparati dhe një kamere. - Diskutimi përshëndetës, rrjedha e Kuvendit. - Pritja e mysafirëve. • Propozimi i emrave për ndarjen e mirënjohjeve në Kuvendin e nëntë. <p>Pjesa e dytë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i promovimit të dy librave të autorit Agim Shehu. • Organizimi i paraqitjes të dy librave të autorit Mehmet Haxhosaj. • Të ndryshme 	Ftesë, Protokoli i mbledhjes	<p>AXH</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>AXH, IR</p> <p>Të gjithë</p> <p>AXH</p> <p>AM, LLB, IR</p> <p>Të gjithë</p> <p>IR, AXH</p> <p>IR</p> <p>AXH, SSH</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>AXH, AF</p> <p>AXH, AF</p> <p>Të gjithë</p>

Vërejtje: Në periudhën 19.11.2005–18.11.2006, të gjithë anëtarët aktual të kryesisë së BISHZ-së kanë treguar angazhim të duhur siq është pritur.

5. Sekretariati

Në këtë kapitull është dhënë lista e detalizuar e aktivitetit të Sekretariatit në periudhën 19.11.2005 – 18.11.2006.

AKTIVITETI I GJERËTANISHËM I SEKRETARIATIT					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
01	08.04.06	Njoftim-Ftesë	Caktimi i pikave të rendit për mbledhën e parë të kryesisë për datën 22.04.06 dhe dërgimi i ftesave anëtarëve të kryesisë dhe administratorëve të BISHZ-së	Ftesë	AXH
02	22.04.06	Mbledhja e parë e Sekretariatit të BISHZ-së	Vendi i mbajtjes: Qendra e nënave –Mutter Zentrum Wildmannstrasse 15, 3027 Bern-Bethlehm Data: E shtunë, 22 prill 2006 / 16.00-17.00 Kryesues: Ahmet Xhigoli Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar) Pjesëmarrës: Ahmet Xhigoli, Sinollah Shehu, Abas Fejzullahi, Ismet Rexhaj. <u>Pikat e rendit të mbledhjes</u> <ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtimi i rrjedhës së pikave të rendit të mbledhjes parë të kryesisë • Plani i aktiviteteve të BISHZ-së për vitin 2006. • Plani i organizimit të mbledhjeve të Kryesisë, Sekretariatit dhe Kuvendit të tetë të rregullt. • Të ndryshme 	Ftesë, Protokoli i mbledhjes	AXH Të gjithë AXH AXH Të gjithë
03	06.07.06	Mbledhja e dytë e Sekretariatit të BISHZ-së	Vendi i mbajtjes: Ndërtesa e SBB-së në Bernë (afër stacionit kryesor). Data: E enjte, 7 korrik 2006, 16.00 - 18.30 Kryesues dhe protokoli: Ahmet Xhigoli Pjesëmarrës: Ahmet Xhigoli, Ismet Rexhaj <u>Pikat e rendit të mbledhjes</u> <ul style="list-style-type: none"> • Gjendja e pagesës së anëtarësisë për vitin 2006. • Përfundimi i aktiviteteve të gjertanishme • Kryerja e pagesave 	Ftesë, Protokoli i mbledhjes	AXH AXH, IR AXH, IR AXH, IR
04	10.10.06	Njoftim-Ftesë	Caktimi i pikave të rendit për mbledhën e dytë të kryesisë për datën 27.10.06 dhe dërgimi i ftesave anëtarëve të kryesisë dhe administratorëve të BISHZ-së	Ftesë	AXH
05	27.10.06	Mbledhja e tretë e Sekretariatit të BISHZ-së	Vendi i mbajtjes: Qendra e nënave –Mutter Zentrum Wildmannstrasse 15, 3027 Bern-Bethlehm Data: E shtunë, 27 tetor 2006 / 16.00-17.00 Kryesues: Ahmet Xhigoli Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar) Pjesëmarrës: Ahmet Xhigoli, Sinollah Shehu, Abas Fejzullahi, Ismet Rexhaj. <u>Pikat e rendit të mbledhjes</u> <ul style="list-style-type: none"> • Vërejtjet dhe plotësimet e protokolit të mbledhjes së shtatë të Sekretariatit të datës 22.04.2006, dhe aprovimi i tij. • Gjendja e pagesës së anëtarësisë për vitin 2006. • Përfundimi i aktiviteteve të gjertanishme • Paraqitja e shpenzimeve dhe raporteve • Promovimet/Paraqitjet e librave më 18.11.06 	Ftesë, Protokoli i mbledhjes	AXH Të gjithë AXH, IR Të gjithë AXH, IR AXH, AF
06	16.11.06	Mbledhja e katërt e Sekretariatit të BISHZ-së	Vendi i mbajtjes: Ndërtesa e SBB-së në Bernë (afër stacionit kryesor). Data: E enjte, 16 nëntor 2006, 16.30 - 19.00 Kryesues dhe protokoli: Ahmet Xhigoli Pjesëmarrës: Ahmet Xhigoli, Ismet Rexhaj	Ftesë, Protokoli i mbledhjes	AXH

		<p><u>Pikat e rendit të mbledhjes</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Shtypja e raportit vjetor nr. 9 • Shtypja e mirënjohjeve • Të ndryshme 	<p>IR, AXH</p> <p>IR, AXH</p> <p>IR, AXH</p>
--	--	--	--

Vërejtje: Në periudhën 19.11.2005 – 18.11.2006, anëtarët e sekretariatit të BISHZ-së kanë treguar angazhim të duhur siq është pritur.

6. Seksionet e BISHZ-së

Veprimtaria e seksioneve të BISHZ-së për këtë vit është bërë në formë të bashkuar. Në këtë drejtim janë realizuar: një turnir në futboll të vogël, një takim familjar, një tryezë e rrumbullakët me veprimtarët, intelektualët shqiptarë dhe gazetarët nga Zvicra; dhe më 18.11.2006, pas përmbylljeve të punimeve Kuvendit të nëntë të rregullt do të bëhet promovimi i dy librave: "Fisnikëria Helveto-Ilire" dhe "Amerika në syt e mi" të autorit Agim Shehu dhe paraqitja e dy librave poetike "Pesha e gurit" dhe "Fillo me të mbarë" të autorit Mehmet Haxhosaj.

6.1. Organizimi i Turnirit në futboll të vogël

Të dielën e 7 majit 2006, prej orës 12.00-16.30, Seksioni për sport i BISHZ-së ka organizuar Turnirin e tretë në futboll të vogël në Gerlafingen të Kantonit Solothurn.

Në këtë turnir morën pjesë 8 ekipe me rreth 60 lojtarë të moshave 10-14 vjeç, nga kantonet e ndryshme të Zvicrës, ku punojnë dhe jetojnë mërgimtarët tanë nga të gjitha trojet etnike. Pjesëmarrja e ekipeve sportive ishte Fr. 30 për ekip. Emrat e ekipeve që morën pjesë janë: Ilira nga Biberist (SO) me trainerin e tyre Rrahim Dakaj; Adler nga Ipsach (BE) me trainerin e tyre Besim Gërzhaliu; Çabrat nga Sisseln (AG) me trainerin e tyre Sinollah Shehu; Prishtina nga Bellach (SO) me trainerin e tyre Ahmet Xhigoli, Barcelona nga Solothurn (SO) me trainerin e tyre Ferat Dakaj; Shqipi Boys nga Gerlafingen (SO) me trainerët e tyre Halim Spahija dhe Valon Morina, dhe Bern West nga Berna (BE) me trainerin e tyre Islam Ramadani. Çdo ekip përbëhej prej 7 lojtarëve.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve (lojtarëve, prindërve të lojtarëve, familjarëve të tyre, dashamirëve të sportit) në takimin e përmendur ishte rreth 130 veta.

Turniri filloi në ora 13:00. Pra, sipas palnit të përpiluar nga udhëheqësi i seksionit për sport i BISHZ-së, z. Agim Gerbavci.



Disa sequenca të rreshtimit të lojtarëve dhe trainerëve. Gjithçka gati për të filluar lojrat e parapapara sipas Agim Gerbavci.



Në anën e majtë janë lojtarët e ekipit "Prishtina" nga Bellach (SO) me trenerin e tyre Ahmet Xhigoli, kurse në anën e djathtë lojtarët e ekipit "Barcelona" nga Solothurn (SO), me trenerin e tyre Ferat Dakaj.



Në anën e majtë janë lojtarët e ekipit "Dardania" nga Grenchen (SO) me trenerin e tyre Agim Gerbavci, kurse në anën e djathtë lojtarët e ekipit "Adler" nga Ipsach (BE), me trenerin e tyre Besim Gërxfhalii.



Në anën e majtë janë lojtarët e ekipit "Iliria" nga Biberist (SO) me trenerin e tyre Rrahim Dakaj, kurse në anën e djathtë lojtarët e ekipit "Çabrati" nga Sisseln (AG), më përcjellësit e tyre Artan Zuberi dhe Shaip Avdyli.



Në anën e majtë janë lojtarët e ekipit "Bern West" nga Berna (BE) me trenerin e tyre Islam Ramadani, kurse në anën e djathtë lojtarët e ekipit "Shqipi Boys" nga Gerlafingen (SO), me trenerët e tyre Halim Spahija dhe Valon Morina.

Ndeshjet filluan të zhvillohen paralelisht në dy fusha të cilat ishin shumë mirë të pajisura dhe të ndara sipas rregullave të futbollit të vogël. Në fushën I referoi z. Halim Spahija nga Gerlafingen, kurse në fushën II referoi z. Agim Gerbavci, udhëheqës i seksionit për Sport i BISHZ-së. Gjithsej u zhvilluan 18 ndeshje.

Të gjitha ndeshjet e zhvilluara të këtij turniri ishin mjaft dinamike dhe u përcollën nga shikuesit me kureshtje. Vendin e parë në këtë turnir e mori e mori ekipi Shqipi-Boys nga Gerlafingen (SO), vendin e dytë ekipi Barcelona nga Solothurn (SO), kurse vendin e tretë ekipi Adler nga Ipsach (BE).

Pas përfundimit të të gjitha ndeshjeve, pasoi pjesa e ndarjes së medaleve, ku secilit lojtar të ekipit i është ndarë nga një medale e sponsoruar nga Kryesia dhe Seksioni për Sport i BISHZ-së.



Në anën e majtë është kryetari i BISHZ-së duke i lexuar rezultatet e ndeshjeve, kurse në anën e djathtë një foto e ekipit Barcelona, me trenerin e tyre dhe sekretarin e BISHZ-së, pas marrjes së medaleve.

Në fund të kësaj paraqitje të shkurtër, për kontributin në përkrahjen dhe realizimin e këtij turniri, Kryesia e BISHZ-së posaçërisht i falënderonë: miqt e BISHZ-së, Reshit Morina dhe Halim Spahija; nënkryetarin BISHZ-së, inxh. i dipl. Sinollah Shehu; sekretarin e BISHZ-së, Abas Fejzullahi; arkëtarin e BISHZ-së, Ismet Rexhaj; këshillëtarët e BISHZ-së: Agim Gerbavci, Adnan Mehmeti dhe Besim Gërxhaliu dhe të gjithë trenerët e ekipeve.

6.2. Organizimi i Takimit familjar

Më 28 maj 2006, prej orës 11.00-17.00, njejtë si në vitin e kaluar, edhe këtë vit, në shtëpinë e bukur në pyll "Waldhaus Kreuzwegen" në Uerkheim të Zofingnit (Kantoni Aargau), Kryedia e BISHZ-së ka organizuar takimin familjar të anëtarëve të BISHZ-së dhe miqve të tyre.

Në këtë takim merrnin pjesë 25 familje nga vende të ndryshme të Zvicrës, nga Gjeneva, Neuchateli, Sioni, Berna, Grencheni, Solothurni, Aarburgu, Bieli, etj., ku punojnë dhe jetojnë anëtarët e BISHZ-së dhe miqve të tyre, nga të gjitha trojet etnike. Pjesëmarrës në këtë takim ishin rreth 115 persana të brezeve të ndryshme.

Në sequencat e dhëna poshtë shifën grupime të ndryshme të pjesëmarrësve të takimit, dhe me një disponim të në veçantë.



Kryesia e BISHZ-së, u shpreh falënderime dhe përsëritje të singërta të gjithëve që morën pjesë në takimin familjar, të tretin me radhë. Posaçërisht ajo, për kontributin në përkrahjen dhe realizimin e këtij takimi, u shprehë miorënjohje: firmës "Gostivar Handler" nga Rothrist, të pronarit Beqir Beqiri; Besim Gërxhaliu, këshilltar i BISHZ-së dhe kordinator i këtij takimi; Sinollah Shehu, nënkryetar i BISHZ-së; Abas Fejzullahi, sekretar i BISHZ-së; Ismet Rexhaj, arkëtar i BISHZ-së; dhe të gjitha zonjave të shëpive, pjesëmarrëse në këtë takim.

6.3. Organizimi i Tryezës së Rrumbullakët me rastin e 7-vjetorit të çlirimit të Kosovës

Më 10.06.2006, BISHZ-ja ka organizuar Tryezën e Rrumbullakët me veprimtarët, intelektualët shqiptarë dhe gazetarët nga Zvicra. Tryeza ishte e para e këtij lloji në këtë vit, dhe është organizuar me rastin e 7 vjetorit të çlirimit të Kosovës. Në këtë tryezë janë shtjelluar këto tema: kontributi i dr. Ibrahim Rugovës, presidentit të parë të Kosovës për pavarësinë e saj dhe statusi i Kosovës dhe kurthet e negociatave. Tryeza është mbajtur në lokalet e Hotelit "Novotel Bern Expo" në Bernë, në të cilën morën pjesë rreth 35 veta.

Në tryezë janë parqitur 7 referate. Pesë referate ishin nga tema e parë, kurse dy nga tema e dytë.

Në pjesën e parë të tryezës referuan: Skënder Buçpapaj me punimin me titull "Ibrahim Rugova, një epokë e pandërprerë", Shefqet Dibrani me punimet "Ndikimi i filozofisë paqësore të dr. Ibrahim Rugovës në pavarësimin e Kosovës" dhe "Kulti i sakrificimit në lëvizjen paqësore të dr. Ibrahim Rugovës, Elida Buçpapaj me punimin me titull "Ibrahim Rugova dhe gazeta kombëtare Bota Sot" dhe Abas Fejzullahi me punimin me titull "Urëtësia, durimi dhe mençuria si vlera të veçanta të kryetarit të Kosovës dr. Ibrahim Rugova".

Në pjesën e dytë të tryezës referuan: Imer Cacaj me punimin me titull "Një anketë në rrugë lidhur me negociatat e Vjenës" dhe Abas Fejzullahi me punimin me titull "Bisedat e detyruara të Kosovës me Serbinë".

Po ashtu le të përmendim që gazeta Bota Sot i ka botuar të gjitha punimet e paraqitura në Tryezën e Rrumbullakët.

Kryesia e BISHZ-së, i shpreh falenderime dhe përhëndetje të singerta referusëve të cilët morën pjesë me punime në këtë tryezë, Gazetës Bota Sot, dhe të gjithë anëtarëve të Shoqatës të cilët kontribuan në mbarëvajtjen shumë të mirë të tryezës së përmendur.

7. Veprimtaria botuese

Në këtë kapitull është dhënë lista e detalizuar e aktivitetit të Seksionit për veprimtari botuese lidhur me botimet e brendëshme të BISHZ-së për këtë vit. Paraqitja është dhënë në formën tabelare: numri rendor, titulli i botimit dhe viti, dhe përshkrimi i shkurtër i botimit.

BOTIMET E BRENDESHME TË BISHZ-SË		
Nr.	Titulli i botimit dhe viti	Përshkrimi
01	<i>Qëllimet e BISHZ-së për vitin 2006. BISHZ-Bernë, 2006.</i>	Dokumenti përshkruan qëllimet e BISHZ-së për vitin 2006.
02	<i>Bilanci i BISHZ-së për vitin 2006. BISHZ-Bernë, 2006.</i>	Dokumenti paraqet të dhënat e bilancit dhe saldon për vitin 2006 të BISHZ-së
03	<i>Raporti nr. 9 i BISHZ-së. BISHZ-Bernë, 2006.</i>	Dokumenti përshkruan aktivitetin e BISHZ-së për vitin 2006.

8. Lista aktuale e udhëheqësisë së BISHZ-së

Në këtë kapitull është dhënë lista aktuale e udhëheqësisë së BISHZ-së dhe roli i tyre.

<i>Nr.</i>	<i>Shkurtesa</i>	<i>Emri e mbiemri</i>	<i>Roli në BISHZ</i>	<i>Roli tjetër në BISHZ</i>
1.	<i>AXH</i>	<i>Ahmet Xhigoli</i>	<i>Kryetar</i>	Udhëheqës i seksionit për veprimtari botuese; Udhëheqës i seksionit për informim.
2.	<i>SSH</i>	<i>Sinollah Shehu</i>	<i>Nënkryetar</i>	Udhëheqës i seksionit për teknikë.
3.	<i>AF</i>	<i>Abas Fejzullahi</i>	<i>Sekretar</i>	Udhëheqës i seksionit për kulturë; Anëtar i komisionit statutar.
4.	<i>IR</i>	<i>Ismet Rexhaj</i>	<i>Arkëtar</i>	Fotograf dhe kamaraman.
5.	<i>XHS</i>	<i>Xhevat Salihu</i>	<i>Këshilltar</i>	Udhëheqës i seksionit për shëndetësi.
6.	<i>FSH</i>	<i>Fatmir Shabanaj</i>	<i>Këshilltar</i>	Udhëheqës e seksionit për ekonomi.
7.	<i>AM</i>	<i>Adnan Mehmeti</i>	<i>Këshilltar</i>	Zënvendësudhëheqës i seksionit për veprimtari botuese; Kryetar i komisionit të kontroll-revizionit.
8.	<i>FR</i>	<i>Florije Rexhaj</i>	<i>Këshilltare</i>	Udhëheqëse e seksionit për çështje sociale-integrim.
9.	<i>AG</i>	<i>Agim Gerbavci</i>	<i>Këshilltar</i>	Udhëheqës e seksionit për sport.
10.	<i>VG</i>	<i>Venera Gërxfhalu</i>	<i>Këshilltare</i>	Zënvendësudhëheqëse i seksionit për përkthime.
11.	<i>GB</i>	<i>Gani Balaj</i>	<i>Këshilltar</i>	Udhëheqës i seksionit për diplomaci-politikë.
12.	<i>FTH</i>	<i>Florin Thaçi</i>	<i>Këshilltar</i>	Zënvendësudhëheqës i seksionit për shëndetësi; Anëtar i komisionit statutar.
13.	<i>RB</i>	<i>Resmije Berisha</i>	<i>Këshilltare</i>	Udhëheqëse e seksionit për arsim.
14.	<i>BG</i>	<i>Besim Gërxfhalu</i>	<i>Këshilltar</i>	Udhëheqës e seksionit për përkthime.
15.	<i>LLB</i>	<i>Llokman Beqiri</i>	<i>Administrator</i>	Bashkëpunëtor në seksionin për veprimtari botuese; Anëtar i komisionit të kontroll-revizionit.
16.	<i>SHR</i>	<i>Shkumbin Rmoku</i>	<i>Administrator</i>	Bashkëpunëtor në seksionin për veprimtari botuese.
17.	<i>SJ</i>	<i>Skender Jusufi</i>		Kryetar i komisionit statutar.
18.	<i>RSH</i>	<i>Ramiz Shabani</i>		Anëtar i komisionit të kontroll-revizionit.